

VENDIM
Nr.731, datë 1.11.2006

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT “PËR MUNDËSINË E NDËRTIMIT TË
TERMINALEVE TË GAZIT NATYROR TË LËNGËZUAR (GNL) DHE TË
INFRASTRUKTURËS PËRKATËSE, NË BREGDETIN E QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e studimit “Për mundësinë e ndërtimit të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe të infrastrukturës përkatëse, në bregdetin e qarkut të Fierit”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për zonat e përcaktuara në studim, për ndërtimin e terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL), Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me organet përkatëse të njësive të qeverisjes vendore, të përgatisin masterplanin për terminalët dhe për infrastrukturën përkatëse, tokësore dhe detare. Për hapësirat e paraqitura në studim të fillojnë procedurat ligjore për shqyrtimin e tyre edhe në zbatim të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar.

Paraqitja e masterplanit për shqyrtim në KRRTRSH të bëhet brenda datës 20.12.2006.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha